



Programi: Administratë Publike dhe Diplomaci

Studimet Master

Punim masteri

**KOMUNIKIMI I PUSHTETIT LOKAL ME PUBLIKUN  
RASTI I KOMUNËS SË FUSHË KOSOVËS**

Mentori:

Dr. Hasan Saliu

Studentja:

Liridona Ukaj

Prishtinë, 2017

## Përmbajtja

Shkurtesat e përdorura.....	2
Lista e figurave.....	2
Hyrje.....	4
Kapitulli I.....	7
1. Komunikimi i pushtetit lokal me publikun.....	7
1.1 Marrëdhëniet publike.....	10
1.2 Komunikimi publik - politik.....	13
1.3 Komunikimi direkt i pushtetit lokal me qytetar.....	14
1.4 Komunikimi mediatik i pushtetit lokal me qytetar.....	19
1.5 Komunikimi në tubime të ndryshme.....	22
1.6 Komunikimi në tubime elektorale.....	22
Kapitulli II.....	24
2.Menaxhimi i informacionit .....	24
2.1 Propaganda .....	27
2.2 Lideri (lokal) i opinionit.....	30
Kapitulli III.....	33
3 Komunikimi publik në Komunën e Fushë Kosovës.....	33
3.1. Të dhëna mbi komunën e Fushë Kosovës.....	33
3.2 Strategjitë e komunes së Fushë Kosovës për të zhvilluar PR.....	35
3.3 Takimet publike të zyrtarëve me qytetar, në organizime të ndryshme.....	40
3.4 Informimi përmes ueb-it.....	45
3.5 Facebook-u i komunës së Fushë Kosovës.....	47
3.6 Komunikimi përmes e-mailit.....	52
3.7 Komunikimi i komunës së Fushë Kosovës me publikun përmes mediave.....	53

Kapitulli IV.....	57
4. Vërtetimi i hipotezës – të gjetura nga hulumtimi.....	57
4.1 Të gjetura nga anketa me qytetar .....	61
Kapitulli V.....	66
Përfundimi .....	66
Rekomandimet.....	67
Bibliografia.....	69
Shtojca .....	73

Shkurtesat e përdorura:

FK- Fushë- Kosovë

PR- Public Relation

MP- Marrëdhëniet Publike

RAE- Komuniteti Rom, Ashkali, Egjiptas

QKMF- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

ECMI- European Center for Minority Issues

### **Lista e figurave**

- Fig.1. Dallimet ndërmjet komunikimit personal dhe atij masiv 1.1 f. 9.
- Fig.2. Skema se si arrihet deri te marrëdhëniet publike politike 1.2 f. 13.
- Fig. 3. Raporti ndërmjet informacionit, dhënësit dhe marrësit 1.3 f. 18.
- Fig. 4. Lideri i opinionit 2.2 f. 31.
- Fig. 5. Organogrami në komunën e Fushë Kosovës 3.1 f. 33.

- Fig. 6. Ftesë për pjesëmarrje të qytetarëve për programin e organizuar për ditën e çlirimit të komunës së Fushë Kosovës. 3.3 f. 41.
- Fig. 7. Njoftim për diskutim publik. 3.3 f. 43.
- Fig.8. Sllogani “ Ardhmëria është në duart tuaja... bëhuni pjesë e saj”. 3.3 f. 45.
- Fig. 9. Takimi në zyrën e kryetarit Burim Berisha me klubin e shahut të komunës së Fushë Kosovës. 3.5 f. 48.
- Fig. 10. Postimetnga facebook-u, mirëmbajtja e rrugës magjistrale Prishtinë - Fushë Kosovë. 3.5 f. 49.
- Fig. 11. Komentet e qytetarëve në faqen zyrtare të facebook-ut në njërin nga posimet e bëra. 3.5 f. 50.
- Fig. 12. Postim në faqen zyrtare të facebook-ut të komunës së Fushë Kosovës, intervista e kryetarit në portalin bujqësia.org. 3.5 f.51.
- Fig. 13. Të dhënat e zyrës së informimit të komunës së Fushë Kosovës. 3.6 f. 52.
- Fig. 14. E-mail dërguar nga një qytetar zyrës për marrëdhënie me publikun në Fushë Kosovës. 3.6 f. 53.
- Fig. 15. Paraqitja në formë grafike e rezultateve të anketës 4.1 f. 62.
- Fig. 16. Paraqitja në formë grafike e rezultateve të anketës 4.1 f. 63.

## Hyrje

Komunikimi publik i pushtetit lokal është një pikë kyçe dhe mjaft e rëndësishme në zhvillimin e politikave të vetë pushtetit. Zhvillimi i marrëdhënieve me publikun përveç kostos më të ulët që ofron në realizimin e qëllimit të politikës karshi qytetarëve, krijon edhe një afinitet dhe besim mes qytetarëve dhe politikës.

Ky hulumtim shtjellon dhe vë në pah rëndësinë që ka komunikimi në marrëdhëniet midis qytetarëve dhe pushtetit lokal të komunës së Fushë Kosovës, pra marrëdhënieve me publikun (PR-it të komunës). Informimi publik në një shoqëri demokratike është thelbi i vetë demokracisë së atij vendi.

Krijimi i një urë lidhëse ndërmjetë qytetarëve dhe pushtetit lokal të komunës së Fushë Kosovës përmes zyrës së komunikimit, publikimeve në rrjetet sociale, billbordeve dhe programeve mediatike ka arritur që te qytetarët të reflektojë si një pushtet transparent dhe i qasshëm për informacionet dhe kryetari i komunës së Fushë Kosovës z.Burim Berisha në vazhdimësi përçon mesazhe tek publiku me qëllim që të ushtrojë një komunikim politik, për t'i informuar ata, ndikuar, bindur dhe më pas për t'i nxitur për të vepruar. Ky veprim nënkupton që në kohë zgjedhesh qytetari të zgjedhë atë individ apo parti. Pra, një komunikim i pastër politik me qëllim të rritjes së imazhit të individit dhe organizatës politike që e drejton komunën.

Ky lloj komunikimi mund të jetë i drejtpërdrejt ku përfshihen takimet, bisedimet me palët, tubimet e ndryshme pjesëmarrja në evenimente etj, dhe përmes kanaleve të komunikimit masiv, mediave. Të gjitha këto komunikime kanë për qëllim të informojnë publikun për punët dhe angazhimet e komunës me qëllim të ndikimit , duke përdorur strategji dhe kanale të ndryshme komunikimi.

Në këtë hulumtim janë shfrytëzuar instrumente dhe rrugë që na sjellin rezultate të qëndrueshme të verifikuara. Janë përdorur metodat e kombinuara ajo kualitative dhe ajo kuantitative.

Nëpërmjet metodës kualitative, ne kemi realizuar intervista të thella sociologjike me zëdhënësin e komunës, kryetarin, si dhe janë mbikëqyrur brenda periudhës gjashtë mujore (1 janar- 30 qershor 2017) të gjitha postimet e bëra në web faqen e komunës. Kemi monitoruar publikimet e komunës së Fushë Kosovës në media të ndryshme. Gjithashtu kemi monitoruar edhe faqen e Facebook-ut të komunës, duke parë se çfarë postimesh bëhen aty, duke i bërë analizën e përmbajtjes së postimeve, si kombinohet teksti-fotoja, videoja në këto postime.

Gjithashtu kemi analizuar se cilat janë reagimet e publikut/ qytetarëve në këto postime, saëshhtë përqindja e miratimit apo pëlqimit e shpërndarjes (share) etj.

Ndërsa për të parë se cili është efekti i strategjive të ndryshme informuese dhe komunikuese të komunës, nëpërmjet metodës kuantitative kemi realizuar pyetësorët ku kemi anketuar rreth 200 qytetarë të komunës së Fushë Kosovës të moshave dhe vendbanimeve të ndryshme me të drejtë vote, ku kemi mbledhur të dhënat të cilat i japin përgjigje një pjese të këtij raporti të komunikimit. Kjo ka të bëjë me vërtetimin e hipotezes kryesore se individët “aktiv” në shoqëri apo në mjediset e tyre mikrosociale ku liderët (lokal) të opinionit kanë më shumë ndikim sesa informacioni që e marrin qytetarët nga mediat dhe të cilat informacione kanë të bëjnë me çështjet komunale.

Qëllimi i punimit është që në të ardhmen të jetë një kontribut studimor rreth kanaleve të komunikimit mes institucioneve lokale dhe publikut, me qëllim që të promovohen praktika sa më të mira të realizimit të komunikimit mes të dyja palëve.

Gjithashtu ky punim synon që të identifikohen dhe vlersohen në mënyrë kritike format dhe përmbajtja e mesazheve që jepen nga zyrtarë të kësaj komune karshi qytetarëve. Qëllimi i hulumtimi është po ashtu të ndihmoj edhe komunat e tjera rreth komunikimit me qytetarë, pra të shërbejë edhe si bazë për komunikim për organizatat dhe individët e tjerë që kanë përgjegjësi ndaj atyre që përfaqësojnë.

Ky studim është i ndarë në kapituj, ku si tërsi përmbanë gjithsej pesë të tillë. Në kapitullin I shpjegohen nocionet shkencore nga studiues të ndryshëm që flasin për një komunikim të tillë. Gjithashtu bazuar në referenca apo kërkimeve bibliografike, bëhet një shqyrtim i hollësishëm i punimit rreth komunikimit politik dhe akterëve të komunikimit. Në këtë kapitull flasim pse është kaq i rëndësishëm komunikimi mes qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre si dhe pse synojnë organizatat, e në këtë rast komuna të ketë një komunikim të drejtpërdrejt me qytetarët e saj?

Kapitulli II është i fokusuar në shpjegimin e marrëdhënieve politike si dhe flet rreth realizimit të tyre edhe në praktikë. Në këtë kapitull jepen shpjegime edhe rreth menaxhimit të informacionit publik, gjithashtu kemi përmendur edhe propagandën që jo rrallëherë është pjesë e informacioneve drejtuar qytetarëve. Pjesë e këtij kapitulli është edhe tema për liderin (lokal) të opinionit.

Kapitulli III i kushtohet pjesës së komunikimit të realizuar përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit. Jemi ndalur te komunikimi strategjik i komunës me qytetarë, gjithashtu edhe tek komunikimi mediatik i pushtetit lokal të komunës së Fushë Kosovës. Jemi përqëndruar kryesisht edhe tek rrjetet sociale me theks të vaçantë tek facebook-u i komunës së Fushë Kosovës, ku kemi përcjellë dhe analizuar postimet e bëra p.sh cilave ngjarje iu është dhënë përparësi më shumë për promovim në këtë rrjet social, pastaj kemi shikuar edhe rreth numrit të pjesëtarëve që janë anëtarë në këtë faqe (friends), numri i pëlqimeve (like), etj. I gjithë hulumtimi rreth rrjetit social facebook të komunës është bërë gjatë një periudhe kohore janar – qershor 2017.

Në kapitull e IV shpjegohen të gjeturave nga hulumtimi përmes pyetësorëve të cilët u janë drejtuar qytetarëve të komunës së Fushë Kosovës, të të dyja gjinive, moshave të ndryshme me të drejtë vote, komuniteteve të ndryshme si dhe banuesve të zonave të ndryshme të komunës së Fushë Kosovës.

Ndërsa kapitulli i V dhe i fundit i këtij studimi, përfshinë pjesën përmbyllëse të studimit, pra përfundimin e tij. Gjithashtu edhe rekomandimet të cilat kanë dalë nga ky studim me qëllim që t'i shërbejnë edhe pushtetit lokal në të ardhmen për gjetjet në terren lidhur me peshën që ka komunikimi për realizimin e dyanëshëm ndërmjet pushtetit lokal dhe qytetarëve të komunës së Fushë Kosovës.

## Bibliografia

- Baylon, Christian: Mignot, Xavier. *Komunikimi*. 2003.
- Berisha, Ibrahim. *Media agjensët e komunikimeve*. Universiteti AAB. Prishtinë. 2007.
- Brown, John: Gaudin, Pat and Moran, Wendy. *PR and Communication in Local Government and Public Services*. 2013.
- Castelli, Wiley Joelle. *Government Public Relations: A Quantitative Assessment of Government Public Relations Practitioner Roles and Public Relations Model Usage*. University of South Florida.
- Edes, W Bart. *The role of government information officers*. Maastricht, The Netherlands. 2000.
- Ellul, Jacques. *Propaganda. The Formation of Men s Attitude*. Unites States of America. Random House. Reprint of the 1965.
- Fuga, Artan. *Komunikimi në shoqërinë masive*. Tiranë. Papyrus. 2011.
- Frashëri, Midhat. *Plagët tona*. Prishtinë. Rilindja 1996.
- Katz, Elihu & Lazarsfeld, F Paul. *Personal Influence - The Part Played by People in thenow of Mass Communications, (Second printing)* Transaction Publishers. New Brunseïck& London. 2009..
- Markoff, Sheldon. *Menaxhimi krijues i televizionit*. Tiranë. Muza.
- Mekuli, Gëzim. *Mediat dhe Politika 1999-2006*. Mekuli Press. 2006.
- Meunier, Jean-Pierre: Peraya, Daniel. *Hyrje në teoritë e komunikimit*. Botimi i dytë. Tiranë. 2009.
- Musai, Bardhyl: Godele, Jonila: Abdurrahmani, Tidita. *Edukimi Mediatik* . Tiranë 2011.
- Oshafi, Lindita. Bejko, Djana: Vokopola Edlir: Valbona, Karakaçi: Kopliku, Arben. *Mjetet e informim – komunikimit*. Shkodër. Janar 2011.
- Saliu, Hasan. *Komunikimi në Diplomacinë Publike-soft power dhe imazhi ndërkombëtar i Kosovës*. AAB. Prishtinë. 2015.
- Strömbäck, Jesper: Kioussis, Spiro. *Political Public Relation, Principles and Applications*. Routledge Taylor&Francis Group. New York and London. 2011.



Taska, Evis. Zela, Nora. Administrata Shqiptare drejt Komunikimit. *Efektiv përmes Marrëdhënieve Publike*. Departamenti i Administratës Publike Ministria e Brendshme . Tiranë. PEGI.

Todorov, Antonij: Kanev, Dobrin: Angelova, Ilija: Radev, Ivan: Nikovol, Ivelin: Kaneva, Liljana: Dikova, Magdalena: Buruxhieva, Tetjana: Georgiev, Julian. *Menaxhment I politik*. Sofje 2001.

Verčić Dejan, Verčić Ana Tkalac, Sriramesh Krishnamurthy ,White John. *New Generation New Media, New Rols*. University of Ljubljana Faculty of Social Sciences. 2014.

### **Artikuj shkencorë:**

Saliu, Hasan. “Propaganda dhe imazhi në rastin e incidentit të Kumanovës”.Thesis.Universiteti AAB, Prishtinë: 2015/2. (f. 95-105). <https://aab-edu.net/assets/uploads/2016/12/02-2015-SQ-10-Hasan-Saliu.pdf> (parë për herë të fundit: 12.06.2017)

Saliu, Hasan.“Propaganda serbe në raportin e Dick Marty-t”,Thesis. Universiteti AAB. Prishtinë: 2012/1. (f. 67-77) <https://aab-edu.net/assets/uploads/2016/11/01-2012-SQ-07-Hasan-Saliu.pdf> (parë për herë të fundit: 18.05.2017)

Zajmi,Ilire.“Identiteti online”. Thesis.Universiteti AAB. Prishtinë: 2015/2.(f.349-359)<https://aab-edu.net/assets/uploads/2016/12/02-2015-SQ-29-Ilire-Zajmi-Rugova.pdf>(parë për herë të fundit: 18.05.2017)

### **Udhëzues dhe manuale**

Agjensioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), - Informimi, komunikimi dhe pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, 2013. f. 4.

Komisioni European, Zyra për Bashkëpunim EuropeAid, Doracak i komunikimit dhe dukshmërisë 2010 EuropeAid për Projektet e jashtme të Bashkimit. f. 17.

Organizata efektive e punëdhënësve. Komunikimi bindës, (Qendra Ndërkombëtare e Trajnimit e Organizatës Ndërkombëtare të Punës 2015) [http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/ecms\\_437242.pdf](http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/ecms_437242.pdf) (vizituar më 17 maj 2017)

Manual për marrëdhëniet e njësisë vendore me publikun - <http://www.aset-al.com/dokumente/manual.pdf> (vizituar me 14 prill 2017).

Zyra për Informim Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal RKS, Procesi i decentralizimit dhe komunikimit me qytetarë [https://mapl.rks-gov.net/getattachment/Publications/Fushata-informuese/Broshura\\_decentralizimi\\_shqip.pdf.aspx](https://mapl.rks-gov.net/getattachment/Publications/Fushata-informuese/Broshura_decentralizimi_shqip.pdf.aspx) (vizituar me 19 maj 2017).

### **Ligje, shkrime online, web - site zyrtare, raporte televizive.**

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut  
<https://www.google.com/#q=konventa+per+drejtat+e+njeriut> (Vizituar me 17 prill 2017).

Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës , Ligji nr. 03/L-040 për vetë qeverisje lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530> (vizituar me 17 prill 2017).

Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Ligji për qasje në dokumentet zyrtare në Republikën e Kosovës. Ligji nr. 03/L-215 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2724> (vizituar me 20 prill 2017).

Ueb site i komunës së Fushë Kosovës , <https://kk.rks-gov.net/fushekosove/City-guide/Geography.aspx> (vizituar me 25 maj 2017)

Faqja zyrtare në Facebook e komunës së Fushë Kosovës  
<https://www.facebook.com/FusheKosovaMunicipality/> (vizituar me 25 maj 2017).

Portali Kosovapress.com shkruan për bashkëpunimin e komunës së Fushë Kosovës me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit lidhur me marrëveshjen për bashkëpunim financiar për ndërtimin e sallës sportive në këtë komunë <http://www.kosovapress.com/sq/sport/fushe-kosova-behet-me-palester-sportive-108546/> (vizituar me 14 qershor 2017)

Tribuna Chanel kronik për komunën e Fushë Kosovës.  
<https://www.youtube.com/watch?v=vzHEVJgMBQM>

Indeksonline shkruan për komunën e Fushë Kosovës, tema: qeraja që paguan komuna për shfrytëzimin e objektit komunal. <http://indiksonline.net/lajmet/komuna-e-fushe-kosoves-vazhdon-te-paguaj-qera-buxhetit-i-kushtoi-780-mije-euro-63405/>

Kronik për komunën e FushëKosovës përgatitur nga KTV. Publikuar me 22 mars 2017. <http://www.koha.net/arberi/7331/fushe-kosova-ende-me-reduktime-ujj/> (vizituar 14 qershor 2017).

Shkrim në portalin koha.net titulli: Mbipopullohen klasat në shkollën “Mihal Grameno” <http://archive.koha.net/?id=9&l=140009> (vizituar me 14 qershor 2017).

Ueb i komunës së Fushë Kosovës <https://kk.rks-gov.net/fushekosove/Lajmet/12-Qershori---Dita-e-clirimit-te-Fushe-Kosoves.aspx> (vizituar me 20 maj 2017).

Ueb- i komunës së Fushë Kosovës, <https://kk.rks-gov.net/fushekosove/Lajmet/Aktivitete-me-rastin-e-shenimit-te-9-%E2%80%93-Vjetorit-te.aspx> (vizituar me 21 maj 2017).

Raport televiziv – Clic channel, <https://www.youtube.com/ëatch?v=cbdJ-C4PqZo>

Shkrim në lajme.gen.al. <http://www.lajme.gen.al/2013-10-24/strategjia-e-komunikimit-thebesore-ne-mbarevajtjen-e-ceshtjeve.html> (vizituar më 17 maj 2017).

Shkrim në ueb-in Albeu, nga Artan Fuga. <http://www.albeu.com/opinion/artan-fuga/cfare-ka-pertej-mediave/26369/> (vizituar më 13 maj).

## **Intervista**

Burim Berisha, kryetari i komunës së Fushë Kosovës, intervistë për këtë studim, 11 qershor, 2017.

Ali Topalli, zëdhënës i komunës së Fushë Kosovës, intervistë për këtë studim, 5 qershor, 2017.

Sokol Osmani, qytetar i komunës së Fushë Kosovës, i intervistuar për këtë studim.